

THIRRJE PËR APLIKIME PROJEKTESH

Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA, në përmbushje të objektivave, funksioneve dhe kompetencave sipas ligjit organik 97/2013, bazuar dhe në Strategjinë dhe Planin e Veprimit për periudhën 2017-2019, shpall këtë thirrje për aplikim për institucione dhe organizata, të cilat punojnë dhe kontribuojnë në fushën e medias.

Subjektet e interesuara ftohen që, brenda datës 02.03.2018, ora 13.00, të paraqesin dorazi, në zyrën e protokollit të AMA-s projekte sipas aspekteve të mëposhtme:

a-studim tregu mbi impaktin e përmbajtjet e transmetuara në mediat audiovizive shqiptare në kushtet e ndryshimeve të shpejta teknologjike, përhapjes në shkallë të gjerë të internetit dhe rrjeteve sociale; duke e shqyrtuar ofertën programore në gjithë përbërësit e vet: pluralizëm, diversifikim kulturor dhe tematik, cilësinë e programeve, si dhe në perceptimin e audiencave për to;

b-organizim veprimtarish trajnimesh dhe ndërgjegjësimi me gazetarët dhe drejtuesit e mediave audiovizive në respektim të Kodit të Transmetimit të AMA-s, akt nënligjor që është ndryshuar në mes të muajit dhjetor 2017, duke u fokusuar te përmirësimi i raportimeve dhe mbulimeve të ngjarjeve në aspekte të tilla, si:

- respektimi i të drejtave dhe lirive të fëmijëve, mbrojtja e tyre në transmetimet e përmbajtjeve audiovizive;*
- respektimi i barazisë gjinore, kundër dhunës në familje dhe çdo forme të ushtrimit të saj;*
- shmangia në programe i përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit në të gjitha format e shfaqjes;*
- procesi i edukimit mediatik në radhët e të rinjve, perceptimet dhe vlerësimet e tyre për përmbajtjet e transmetuara në mediat audiovizive;*

c-organizim veprimtarish trajnimesh dhe ndërgjegjësimi me gazetarët dhe drejtuesit e mediave audiovizive mbi sfidat e raportimit në një realitet gjithnjë e më shumë konkurrues, të përhapjes dhe të informacioneve të pakonfirmuara dhe spekulative, por dhe nevojës që ka publiku për përmbajtje cilësore dhe të shumëllojshme;

d-përkthimin në shqip dhe publikimin e literaturës bashkëkohore nga fusha e mediave audiovizive (ku subjekti siguron sipas legjislacionit në fuqi dhe garanton të drejtat përkatëse autoriale).

Aplikimi, detyrimisht, përshtatet në përmbajtje sipas modelit të formularit që gjendet në faqen online të AMA-s, (Formular për Aplikim Projekti), duke plotësuar çdo kërkesë të tij. Gjithashtu, më shumë shpjegime për procesin e aplikimit gjeni në udhëzimin përkatës (Udhëzim për Aplikim), i cili po ashtu gjendet në faqen online të institucionit www.ama.gov.al.

Në planin buxhetor të projektit të propozuar, vetë aplikuesi, detyrimisht duhet të ketë të pasqyruar një angazhim vetëfinancues jo më pak se 25% të vlerës totale të buxhetit.

Subjektet e interesuara, të cilat nuk respektojnë afatin kohor dhe nuk kanë plotësuar të gjitha kërkesat e formularit, konsiderohen automatikisht të skualifikuara nga procesi aplikues.

Projektet duhet të planifikohen nga aplikuesit në mënyrë që finalizimi i tyre me produkte, evente, si dhe dorëzimin e të gjithë dosjes së dokumentacionit përkatës të bëhet brenda datës 05.12.2018.

AMA do të vijojë komunikimin dhe procedimin e mëtejshëm vetëm me ata aplikues të cilëve iu vlerësohet projekti në përputhje me kërkesat e kësaj Thirrjeje.

Autoriteti i Mediave Audiovizive

Tiranë më 01 Shkurt, 2018